



**KONTRATE PER SHITJEN
E KUOTES SE KAPITALIT
(TË SHOQËRISË “TREMA INVESTMENT” SH.P.K)**

Sot, me 15 Janar 2024 (dymije e njezet e katër), ditën e Hënë, perpara meje Noteres Donika A. Gjini, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr.Emin Duraku, Tirane, u paraqiten palet e meposhtme, te cilet me deklaruan se duan te lidhin kete Kontrate per Shitjen e Kuotes se Kapitalit (me poshte quajtur “Kontrata”):

SHITES:

Shoqeria “TREMA TECH” shpk, shoqeri e se drejtes shqiptare, regjistruar prane QKB date 09.01.2008, me NIPT K81309063C, me seli te regjistruar ne adresen: Rruga Ibrahim Rugova, Ndertesa 40, Hyrja 2, Kati 2, Nr 4, Tirane Kodi Postar 1001, Tirane, e perfaqsuar nga Administratori Ilir Trebicka, lindur me 25.05.1954, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033134069 dhe nr.personal F40525164W (me poshte i quajtur “*Shitësi*”);

BLERES:

Ilir TREBICKA, atesia Polikron, amesia Lirika, shtetas Shqiptar, lindur me 25.05.1954, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, ne adresen: Rr.brahim Rugova, Nd. 58, H. 3, Ap. 11, Njësia Bashkiake nr. 5, 1019, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033134069 dhe nr.personal F40525164W, (me poshte i quajtur “*Blerësi*”);

MEQENESE:

- A. Referuar Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar Shitesit zoteron 1 kuote qe perben 40% te perqindjes se pjesemarrjes ne Kapital referuar Ligjit 9901, date 14.04.2008 per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, (i ndryshuar), ne Kapitalin e Shoqerise “Trema Investment” shpk, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar me nr. NUIS M31327008S ne Qendren Kombetare te Biznesit te Republikes se Shqiperise, me seli ne Tirane, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati 40/2/4, Njesia Bashkiake Nr.5, (me poshte e quajtur “SHOQERIA”).
- B. Bleresi deshiron te bleje kuoten e Shitesit qe perben 40% te kapitalit (me poshte referuar si “*kuota target*”).

Duke patur parasysh sa me lart palet bien dakort per sa vijon:

NENI 1 SHITJA DHE TRANSFERIMI I PRONESISE

- 1.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesit i shet Bleresit kuoten e tij qe i korrespondon me 40% te perqindjes ne Kapitalin e Shoqerise dhe çdo te drejte te lidhur me te dhe/ose qe rrjedh prej saj.
- 1.2 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesit zhvishet teresisht nga pronesia mbi Kuoten Target dhe te drejtat e tjera qe lidhen me te dhe ose rrjedhin prej saj, perfshire te drejten e votes dhe te dividendit te cilat i kalojne Bleresit i cili behet pronar i 1 Kuote qe perben 40% te perqindjes se pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise.
- 1.3 Shitesit çlirohet teresisht nga te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i Kuotes menjehere me nenshkrimin e kontrates dhe regjistrimin e kalimit te kuotes ne Qendren Kombetare te Biznesit.

1



A2024052970002382027

NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1 Bleresi bie dakord dhe angazhohet t'i paguaje Shitesit vleren prej 40,000 Leke (dyzet mije leke) te Kuotes Target se Shitesit (referuar nenit 1.1), (me poshte i quajtur Çmimi i Shitjes).
- 2.2 Shitesi dhe Bleresi deklarojne qe titulli i pronesise mbi Kuoten e Shitesit do kaloje me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe Çmimi i Shitjes eshte paguar cash ndermjet paleve.
- 2.3 Ne fund te transaksionit Shoqeri do te zoterohet nga:
- Ilir Trebicka qe do te zoteroje 1 (nje) kuote qe do te perbeje 40% te kapitalit te Shoqerise;
 - Ilir Hoxhallari do te vazhdoje te zoteroje 1 (nje) kuote qe do te perbeje 20% te kapitalit te Shoqerise;
 - Yusuf Gökdemir do te vazhdoje te zoteroje 1 (nje) kuote qe do te perbeje 20% te kapitalit te Shoqerise; dhe
 - Ermal Koka do te vazhdoje te zoteroje 1 (nje) kuote qe do te perbeje 20% te kapitalit te Shoqerise.

NENI 3 DEKLARIME DHE GARANCI

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Shitesin.
- 3.2 Bleresi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Bleresin. Gjithashtu, Bleresi i pranon Kuotat e Shitesit objekt i kesaj Kontrate ne gjendjen te cilat ato jane dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me to apo te drejta qe lidhen me to dhe/ose rrjedhin prej tyre. Bleresi garanton Shitesin se parate per pagimin e Çmimit te Shitjes nuk burojne nga asnje aktivitet i kunderligjshem.

NENI 4 TE NDRYSHME

- 4.1 Secila prej paleve do te perballoje shpenzimet e veta ne lidhje me negocimin, nenshkrimin dhe permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kete Kontrate.
- 4.2 Palet angazhohen te regjistrojne menjehere Kontraten ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 4.3 Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruhet ne kater origjinale me vlere te njejte secili dhe ky akt perben te gjithe marreveshjen e arritur midis paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet personalisht nga palet e kesaj Kontrate apo perfaqesues te autorizuar rregullisht prej seciles nga palet ne fjale. Bleresit dhe Shitesi marrin nga nje origjinal te kesaj Kontrate ndera nje origjinal i Kontrates arkivohet nga une Noteri.

NENI 5 LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

- 5.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.
- 5.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

2




A2024052970002382027

- 5.3 Kontrata e Shitjes, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.
- 5.4 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 39 dhe 51 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë” vërtetoj nënshkrimin e tyre në përputhje të plotë me ligjin.
- 5.5 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITES:


Shoqeria “TREMA TECH” shpk
Perfaqshuar nga Administratori
Ilir TREBICKA




TREMA TECH
Rruga Ibrahim Rugova
Ndërtesa 40, Hyrja 2, Kati 2 nr 4, Tiranë
- K 8 1 3 0 9 0 6 3 C -

BLERES:

Ilir TREBICKA



NOTERE

Donika A. GJINI



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K81309063C	
2. Data e Regjistrimit	09/01/2008	
3. Emri i Subjektit	TREMA TECH	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	08/01/2008	
6. Kohëzgjatja	Nga: 08/01/2008	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Ibrahim Rugova, Ndertesa 40, Hyrja 2, Kati 2, Nr 4, Tirane Kodi Postar 1001.	
8. Kapitali	12.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Shit-bleje të pjesëve të nderrimit.Importimin dhe eksportimin e makinerive dhe pjesëve të nderrimit.Ofrimi i asistencës dhe shërbimit.Veprimtari tregtare në përgjithësi.Ndërtim, projektim të veprave të ndryshme.	
10. Administratori/ët	Ilir Trebicka	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 25/09/2023	Deri: 25/09/2028
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	MAZARS	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 23/02/2023	Deri: 23/02/2024
13. Ortakët	IlirTrebicka	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 9.600.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	80,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	80,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
14. Ortakët	BledarTrebicka	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 2.400.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	20,00	

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE
TË SHOQERISË “TREMA TECH” SHPK

NIPT K81309063C

Selia: Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa 40, Hyrja 2, Kati 2, Nr 4, Tiranë Kodi Postar 1001

Sot më 15 Janar 2024, nga Administratori i Shoqërisë “TREMA TECH” shpk, u thirr Mbledhja e Asamblesë së zakonshme të Ortakëve të Shoqërisë “TREMA TECH” shpk (këtu e në vijim “Shoqëria”).

Në mbledhje u paraqitën:

1. **Ilir Trebicka**, si zotërues i një kuote që përbën 80% (tetedhjetë) të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë.
2. **Bledar Trebicka**, si zotërues i një kuote që përbën 20% (njetzet) të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë.

Asambleja u thirr dhe mbledh rregullisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parashikimet e Statutit, përfaqsohen 100% të ortakëve të Shoqërisë dhe Asambleja mund të marrë vendime ligjore efektive sipas rendit të ditës.

Rendi i ditës:

1. Diskutimin mbi shitjen nga ana e Shoqërisë të 1 (nje) kuote të Shoqërisë “Trema Investment” shpk;
2. Të tjera

Pas diskutimit të çështjeve Asambleja e Ortakëve miraton vendimet e mëposhtme:

I. Vendimi I Pare

Ortakët miratojnë shitjen e kuotës të zotëruar nga Trema Tech në Shoqërinë “Trema Investment” shpk që përbën 40% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë për çmimin e shitjes prej 40,000Leke.

Shitjen e kësaj kuote Z Ilir Trebicka


II. Vendimi I Dytë

Autorizohet Administratori i Shoqërisë për të nënshkruar kontratën e shitblerjes dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për përmbushjen e këtij qëllimi.


Meqenëse Asambleja e Ortakëve nuk ka më çështje të tjera për të diskutuar, Mbledhja u mbyll. Siç diskutuan dhe miratuan në këtë mbledhje, Vendimet u nënshkruan nga të gjithë pjesëmarrësit personalisht.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË
SHOQËRISË “TREMA TECH” SHPK

Ilir TREBICKA



Bledar TREBICKA



VENDIM ASAMBLEJE

I ORTAKËVE TË SHOQËRISË “TREMA INVESTMENT” SH.P.K.

NIPT M31327008S

Selia: Rr. Ibrahim Rugova, Pallati 40/2/4, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane

Sot në datë 15 Janar 2024, u mbledh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë “TREMA INVESTMENT” shpk (“Shoqëria”), e përbërë nga:

1. **Shoqëria Trema Tech**, zoterues i 1 (një) kuote që përbën 40% të kapitalit të Shoqërisë, përfaqshuar nga **Z. Ilir Trebicka**
2. **Z. Ilir Hoxhallari**, zotërues i 1 (një) kuote që përbën 20% të kapitalit të Shoqërisë;
3. **Z. Yusuf GÖKDEMİR**, zotërues i 1 (një) kuote që përbën 20% të kapitalit të Shoqërisë; dhe
4. **Z. Ermal KOKA**, zotërues i 1 (një) kuote që përbën 20% të kapitalit të Shoqërisë.

Asambleja është thirrur rregullisht në përputhje me kërkesat ligjore dhe të statutit të saj, në mbledhje përfaqshohen tërësisht pjesët e kapitalit themeltar, dhe është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur me rendin e ditës si më poshtë vijon

1. Shitjen e 1 (një) kuote të Shoqërisë;
2. Të tjera.

Pas diskutimit të çështjeve Asambleja e Ortakëve miraton vendimet e mëposhtme:

I. Vendimi i Parë

Ortakët miratojnë unanimisht shitjen e kuotës së zotëruar nga Ortaku Shoqëria “Trema Tech” shpk tek Bleresi Ilir Trebicka për çmimin e shitjes prej 40,000Lekë.

Ortakët Ilir Hoxhallari, Yusuf Gökdemir dhe Ermal Koka heqin dorë nga e drejta e parablerjes së kuotës së zotëruar nga ortaku Shoqëria Trema Tech duke mos patur asnjë pretendim të sotëm apo të ardhshëm mbi këtë të drejtë dhe japin miratimin e tyre të plote për futjen në shoqëri të ortakut të ri Z Ilir Trebicka

Autorizohet Administratori i Shoqërisë për të depozituar Kontratën si dhe çdo akt të kërkuar për realizimin e qëllimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Meqënëse asambleja nuk ka çështje të tjera për të diskutuar, mbledhja mbyllet. Për sa u diskutua në mbledhje u mbajt ky vendim, i cili nënshkruhet nga pjesëmarrësit personalisht, pasi ai u lexua me zë të lartë. Meqënëse asambleja nuk ka çështje të tjera për të diskutuar, mbledhja mbyllet. Për sa u diskutua në mbledhje u mbajt ky vendim, i cili nënshkruhet nga pjesëmarrësit personalisht, pasi ai u lexua me zë të lartë.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

TË SHOQËRISË “TREMA INVESTMENT” SHPK

Ilir HOXHALLARI

Yusuf GÖKDEMİR

Ermal KOKA

Shoqëria Trema Tech

Ilir TREBICKA

TREMA INVESTMENT Sh.p.k
Rruga Ibrahim Rugova
Ndërtesa 40 Hyrja 2 Nr. 4, Tiranë
- M 3 1 3 2 7 0 0 8 S -

TREMA TECH
Rruga Ibrahim Rugova
Ndërtesa 40, Hyrja 2, Kati 2 nr 4, Tiranë
- K 8 1 3 0 9 0 6 3 C -